V E N D I M
Nr.589, datë 28.8.2003

PËR NGRITJEN DHE VËNIEN NË FUNKSIONIM TË QENDRËS PRITËSE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 10 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" të shkronjës "e" të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen dhe vënien në funksionim të qendrës pritëse të viktimave të trafikut (që më poshtë do të përdoret qendra) në Linzë Tiranë.

2. Objekti ku do të vendoset qendra, i cili është në administrim të Ministrisë së Rendit Publik, i kalon në administrim Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Me përfundimin e veprimtarisë së qendrës, objekti i rikthehet në administrim Ministrisë së Rendit Publik.

3. Në qendër të trajtohen viktimat e trafikut, shqiptarë dhe të huaj, si gra, vajza, fëmijë dhe emigrantë klandestinë, që kalojnë përmes Shqipërisë.

4. Ruajtja dhe sigurimi i qendrës të bëhet nga Ministria e Rendit Publik, sipas marrëveshjes që do të nënshkruhet ndërmjet saj dhe Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

5. Struktura e qendrës, si institucion i përkujdesit shoqëror, në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, miratohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.

6. Për funksionimin e qendrës, Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, me vendimin nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin për vitin 2003 të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore", i shtohen 22 (njëzet e dy) punonjës.

7. Pagat e punonjësve të kualifikuar të qendrës përcaktohen sipas lidhjes II/M "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave.

8. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", shtohet lidhja II/33 "Niveli i pagave për punonjësit e qendrës pritëse të viktimave të trafikut", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Shpenzimet për investime, që arrijnë vlerën 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohen nga rialokimi i kostos lokale të projektit "Shpërndarja e shërbimeve sociale", ndërsa pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative dhe për mirëmbajtje, që arrijnë shumën 11 600 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të përballohen nga rialokimi i fondeve të pagesës së papunësisë.

10. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Klasa	Shtesë për funksion
1	Drejtor	X	6

2	Përgjegjës sektori/kryetar dege	IX	5
3	Punonjës social	IX	
4	Asistent social	VIII	
5	Shofer	IV	
6	Mirëmbajtës objekti	IV	
7	Magazinier	IV	
7	Kuzhinier	III	
8	Punonjës lavanterie	III	
9	Ndihmëskuzhinier	II	
10	Pastrues	I	

Shënim: Këta punonjës përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune sipas përcaktimit të bërë në pikën 22 të lidhjes II-A, kreu II "Shtesa të tjera" të këtij vendimi.